

# AKT THEMELIMI

## I

### SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### " Century 22" SH.P.K

Sot, më datë 27.03.2023,

**Lirije Bakalli**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 25/10/1963, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038815632 dhe Nr. Personal *G36025071T* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

#### NENI 1

##### Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Century 22**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Century 22**" Sh.P.K.

#### NENI 2

##### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Agjenci Imobilare. Shitje dhe Blerje te te gjitha llojeve te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Agjenci Turistike. Sherbime utilitare si rimbushje dhe pagesa utilitare te te gjitha llojeve. Sherbime marketingu. Sherbime online.

#### NENI 3

##### Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Century 22**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

#### NENI 4

##### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Agjenci Imobilare. Shitje dhe Blerje te te gjitha llojeve te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Agjenci Turistike. Sherbime utilitare si rimbushje dhe pagesa utilitare te te gjitha llojeve. Sherbime marketingu. Sherbime online.

#### NENI 5

##### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Shkodër, Rruga Kole Idromeno, Nr.pasurie 38, zona kadastrale 8594.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**Century 22**" **Sh.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Lirije Bakalli**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 25/10/1963, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038815632 dhe Nr. Personal *G36025071T* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z. Lirije Bakalli**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 25/10/1963, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038815632 dhe Nr. Personal *G36025071T* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Lirije Bakalli**

